**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA GRAMSH**
**KESHILLI BASHKIAK**

Nr. 771/2 Prot                                                                 Gramsh më 07/03/2024

**<u>VENDIM</u>**

**Nr 13 Date 28.02/2024**

**<u>PER</u>**

**<u>KRITERET E PËRDORIMIT TË FONDIT SHTESE MBI FONDIN E KUSHTEZUAR PER NDIHMEN EKONOMIKE.</u>**

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 28/02/ 2024,pasi mori ne shqyrtim Relacionin e Sektorit te Mireqenies dhe Kujdesit Social " Mbi kriteret e perdorimit te fondit te kushtezuar per bllok-ndihmen ekonomike deri ne 6%" mbeshtetur ne Ligjin Nr 57 date 18.07.2019 "Per Asistencen Social ene Republiken e Shqiperise "Neni 21; Ligjin Nr. 139/2015 date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore"neni 8,pika 2;neni 9 ,pika 1.1/a dhe 1.1/b: neni 54 pika ( k) dhe (n);si dhe ne mbeshtetje te Vendimit Nr.597,date 04.09.2019, kreu IV "Per perdorimin e fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmesn ekonomike".

**VENDOSI:**

1.Te miratojë kriteret mbi përdorimin të fondit te kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% si me poshte:

-Te jene familje me kryefamiljare gra.
-Te jene familje ne gjendje te dobet ekonomike.
-Te jene familje me shume anëtare .
-Te jene familje me probleme sociale.

2-Nuk mund te perfitojne ne baze te vendimit 597 date 04.09.2019, familjet te cilat nuk kane aplikuar per ndihme ekonomike nepermjet Regjistrit Elektronik Kombetar, familjet qe trajtohen me ndihme ekonomike , si dhe familjet qe jane perjashtuar nga sistemi per deklarime te rreme.

3-Per Zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Sektori I Mbrojtjes Sociale ,Bashkia Gramsh.
Ky vendim hyne ne fuqi 10 dite pas shpalljes..

**Kryetari Keshillit**
**Enis Zani**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA GRAMSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 363/1 Prot

Elbasan, më 12.3.2024

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË GRAMSH**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.13 datë 29.02.2024 "Për kriteret e përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Majlinda PERRIU**

Lgj.Brigada "17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel.054252138 ëëë.prefektielbasan.gov.al, e-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al